



FONDI SHQIPTAR I ZHVILLIMIT
FORMULARI I NJOFTIMIT TE FITUESIT

[Data : 29.05.2015]

Për: Bashkimin e shoqërive Denis 05 sh.p.k (NIPT K51518029B) & Xhast sh.p.k (NIPT K12512837I)

Procedura e prokurimit: “ **Procedurë e hapur** “ me objekt : “**Zgjerimi i rrugës hyrëse në Pikën Doganore Morinë, Kukës**”.

Përshkrim i shkurtër i kontratës: “**Zgjerimi i rrugës hyrëse në Pikën Doganore Morinë, Kukës**”.
Kohëzgjatja: **5 muaj nga data e nënshkrimit të kontratës.**

Fondi limit: **49.990,000 (dyzet e nëntë milion e nëntëqind e nëntëdhjetë mijë) lekë pa tvsh.**

Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit.

Data e zhvillimit të procedurës së prokurimit: **Date 22.04.2015.**

Publikime të mëparshme (nëse zbatohet): Nuk ka patur.

Njoftojmë se, kanë qënë pjesëmarrës në procedurë këta ofertues me vlerat përkatëse të ofruara pa tvsh:

1. Operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k (NIPT-i K71401004) me vlerë 32,459,843 (tridhjetë e dy milion e katërqind e pesëdhjetë e nëntë mijë e tetëqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH.
2. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Denis 05 sh.p.k (NIPT K51518029B) & Xhast sh.p.k (NIPT K12512837I) me vlerë 32,548,947 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH.
3. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Haziri sh.p.k (NIPT J66702916G) & Ndrejoni sh.p.k (NIPT K31329048I) me vlerë 33,196,699 (tridhjetë e tre milion e njëqind e nëntëdhjetë e gjashtë mijë e gjashtëqind e nëntëdhjetë e nëntë) lekë pa TVSH.
4. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Albshpresa sh.p.k (NIPT J72110003F) & Curri sh.p.k (NIPT J67902718S) & Marsi sh.p.k (NIPT J68028214P) me vlerë 37,205,944 (tridhjetë e shtatë milion e dyqind e pesë mijë e nëntëqind e dyzet e katër) lekë pa TVSH.
5. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Vuthaj sh.p.k (NIPT K67812301C) & Gjukuria sh.p.k (NIPT J62903456H) me vlerë 41,241,362 (dyzet e një milion e dyqind e dyzet e një mijë e treqind e gjashtëdhjetë e dy) lekë pa TVSH.
6. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Be-Is sh.p.k (NIPT K71412003A) & Eglant sh.p.k (NIPT J96829419D) me vlerë 41,918,243 (dyzet e një milion e nëntëqind e tetëmbëdhjetë mijë e dyqind e dyzet e tre) lekë pa TVSH.
7. Operatori ekonomik Salillari sh.p.k (NIPT J62903125G) me vlerë 42,606,682 (dyzet e dy milion e gjashtëqind e gjashtë mijë e gjashtëqind e tetëdhjetë e dy lekë pa TVSH.
8. Operatori ekonomik Alb Building sh.p.k (NIPT J69102508C) me vlerë 43,431,705 (dyzet e tre milion e katërqind e tridhjetë e një mijë e shtatëqind e pesë) lekë pa TVSH.
9. Operatori ekonomik B-93 sh.p.k (NIPT J62903508R) me vlerë 43,821,000 (dyzet e tre milion e tetëqind e njëzet e një mijë) lekë pa TVSH.
10. Operatori ekonomik Vllaznimi sh.p.k (NIPT J79602601O) nuk ka paraqitur ofertë.

Jane skualifikuar ofertuesit e meposhtem:

1. Operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k (NIPT-i K71401004)
2. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Haziri sh.p.k (NIPT J66702916G) & Ndrejoni sh.p.k (NIPT K31329048I)
3. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Albshpresa sh.p.k (NIPT J72110003F) & Curri sh.p.k (NIPT J67902718S) & Marsi sh.p.k (NIPT J68028214P)
4. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Be-Is sh.p.k (NIPT K71412003A) & Eglant sh.p.k (NIPT J96829419D)
5. Operatori ekonomik Alb Building sh.p.k (NIPT J69102508C)
6. Operatori ekonomik B-93 sh.p.k (NIPT J62903508R)

7. Operatori ekonomik Vllaznimi sh.p.k (NIPT J79602601O)

Përkatësisht për arsye të mëposhtme:

1. Operatori ekonomik Kevin Konstruksion sh.p.k:

Nuk plotëson kriterin e realizimit të punimeve të ngjashme të vendosur në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.1: *”Operatori Ekonomik duhet të ketë realizuar punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më pak se 24.000.000 (nëzet e kater milion) leke pa tvsh dhe që është realizuar gjatë tri viteve të fundit.*

Ose

punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku, gjatë tri viteve të fundit, është jo më pak se 99.800.000 (nëntedhjetë e nente million e teteqind mijë) leke pa tvsh.

Plotësimi i njërës prej 2 kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Per te vertetuar plotesimin e ketij kushti Operatori Ekonomik duhet te paraqese formularet e vleresimit sipas shtojces perkatese te DST te shoqeruar me kontraten/kontratat e nenshkruara nga palet, situacionet perfundimtare, aktet e kolaudimit dhe faturat tatimore perkatese”.

Shoqëria Kevin Konstruksion sh.p.k ka paraqitur kontraten “Rikualifikimi urban i bllokut 46” Tirane. Kjo kontrate është e pamjaftueshme për të provuar realizimin e punëve të ngjashme.

Nuk plotëson kriterin për mjetet e kërkuara e vendosur në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.5

Ka paraqitur dokumentacion për disponimin e një makine për shtrim asfalti të markës “Simesa” të cilën e ka marrë me qera nga shoqëria “Albshpresa” shpk, me vërtetim çdoganimit datë 12.09.2000. Këtë makineri e ka paraqitur në tender edhe vetë shoqëria “Albshpresa” shpk.

Ka paraqitur dokumentacion për disponimin e mjetit autobitumatriçe çisterne termike marka Marini, prodhim i vitit 2000, me faturë tatimore nr 86, date 18.11.2008, marrë me qera nga shoqëria “Mela” shpk. Por nga dokumentat e paraqitura në tender nga shoqëria “Albshpresa” shpk rezulton se shoqëria “Mela” shpk në datën 16.05.2013 i ka dhënë me qera për tre vjet shoqërisë “Albshpresa” mjetin autobitumatriçe cisterne termike marka Marini, prodhim I vitit 2000, me faturë tatimore nr 86, date 18.11.2008.

2. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Haziri sh.p.k & Ndregjoni sh.p.k:

Nuk plotëson kriterin e realizimit të punimeve të ngjashme të vendosur në Dokumentat e Tenderit. Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.1.

Të gjitha faturat tatimore të paraqitura për të vërtetuar kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor janë në vitin 2010.

3. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Albshpresa sh.p.k & Curri sh.p.k & Marsi sh.p.k:

Shoqëria Albshpresa shpk nuk plotëson kriterin për disponimin e mjeteve e kërkuara, të vendosur në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.5 : *“Operatori ekonomik duhet të disponojë mjetet dhe paisjet e nevojshme teknike për realizimin e kontrates. Per kete duhet te paraqese deshmi per mjetet dhe paisjet teknike qe ka ne dispozicion apo mund ti vihen ne dispozicion operatorit ekonomik”*.

Ka paraqitur dokumentacion për disponimin e një makine për shtrim asfalti të markës “Simesa” të cilën ja ka dhënë me qera shoqërise Kevin Konstruksion sh.p.k, me vërtetim çdoganimit datë 12.09.2000. Këe makineri e ka paraqitur në tender njëkohësisht si shoqëria Kevin Konstruksion ashtu edhe vetë shoqëria “Albshpresa” shpk. Kontratat janë fiktive dhe në këtë mënyrë kjo shoqëri duhet të skualifikohet

4. Bashkimi i përkohshëm i operatorëve ekonomikë Be-Is sh.p.k & Egland sh.p.k:

Ne sistem nuk gjëndet asnjë dokument për shoqërinë Egland sh.p.k.

5. Operatori ekonomik Alb Building sh.p.k:

Nuk plotëson kriterin e realizimit të punimeve të ngjashme të vendosur në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.1.

Të gjitha faturat tatimore të paraqitura për të vërtetuar kriterin e vendosur nga Autoriteti Kontraktor janë në vitet 2010-2011.

6. Operatori ekonomik B-93 sh.p.k

Nuk plotëson kriterin e numrit të nevojshëm të punonjësve të vendosur në Dokumentat e Tenderit, Shtojca 10, paragrafi 2 “Kriteret e Veçanta të Kualifikimit”, pika 2.4 Kapaciteti Teknik, pika 2.4.2 *“Operatori Ekonomik duhet te kete numrin e nevojshem te punonjesve per zbatimin e kontrates. Numri i punonjesve per periudhen Qershor 2014 deri Shkurt – 2015 te jete mesatarisht jo me pak se 60 (pesedhjetë) punonjës në muaj. Ne kete numer perfshihet dhe stafi drejtues. Kjo te deshmohet me vertetim nga Administrata Tatimore per numrin e punonjesve te siguruar dhe te shoqerohet me formularet E-SIG.”*

Operatori ekonomik ka më pak se 60 punonjës

7. Operatori ekonomik Vllaznimi sh.p.k

Operatori ekonomik nuk ka paraqitur asnjë dokumentacion.

Duke iu referuar procedurës së lartpërmendur, informojmë bashkimin e përkohshëm të operatorëve ekonomik **Denis 05 sh.p.k (NIPT K51518029B) & Xhast sh.p.k (NIPT K12512837I)** se oferta e paraqitur, me një vlerë 32,548,947 (tridhjetë e dy milion e pesëqind e dyzet e tetë mijë e nëntëqind e dyzet e shtatë) lekë pa TVSH është identifikuar si oferta e suksesshme.

Rrjedhimisht, jeni i lutur të paraqisni pranë **Autoritetit Kontraktor:**

- **Fondi Shqiptar i Zhvillimit**
- **Rr. “Sami Frashëri”, Nr. 10, Tirana, Albania**
- **Phone: 00355 4 2 235 597/8 (int.151)**
- **Fax: 00355 4 2 234 885**

sigurimin e kontratës, siç parashikohet në dokumentat e tenderit, brenda pese ditëve nga dita e marrjes/publikimit të këtij njoftimi.

Në rast se nuk pajtoheni me këtë kërkesë, ose tërhiqeni nga nënshkrimi i kontratës, do të konfiskohet sigurimi i ofertës suaj (nëse është kërkuar) dhe kontrata do t’i akordohet ofertuesit vijues në klasifikimin përfundimtar, siç parashikohet në nenin 58 të Ligjit nr.9643 datë 20.11.2006 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar.

Njoftimi i Klasifikimit është bërë në datë **09.05.2015**.

Ankesa: Ka.

Operatori ekonomik “Alb Building” sh.p.k më datë 13/05/2015, ka paraqitur ankesë duke kundërshtuar vendimin e skualifikimit.

Në datën 18/05/2015, Komisioni për shqyrtimin e ankesës ka vendosur refuzimin e ankesës së paraqitur nga operatori ekonomik Alb Building sh.p.k.

